



Prania / Birezua Pundron/Pundate Received/ Delivered	29.04	2022	2	viti goti year
Organ tjetër Organ tjetër Org. /thut	Hi Prot Hi Prot Prot No	Shtesa Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
MASHT	13571/2022		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.299/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe jeton Koca-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.748/2020 të datës 21.03.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.17/2020 të datës 29.01.2020 të parashtruar përmes postës së Kosovës me nr. R8860868 nga përfaqësuesi i autorizuar Avokati _____ për ankuesen _____ me adresë:

_____ në Komunë të Prishtinë, në çështjen juridike “Kompensim material”, kundër organit të punësimit Instituti Pedagogjik i Kosovës/MASHT, duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 28.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa e ankueses _____ me numër Anr.17/2020 e datës 29.01.2020.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ e punësuar në Institutin Pedagogjik të Kosovës, në pozitë “Udhëheqëse e Divizionit për Arsim Parashkollor”, caktohet në ushtrimin e detyrës së Drejtorit të Institutit Pedagogjik të Kosovës(IPK), sipas Vendimit me numër ref.Nr.278/01B të datës 14.12.2017, deri në zgjedhjen e pozitës së Drejtorit të Institutit Pedagogjik të Kosovës(IPK).

Ankuesja, me datë 25.11.2019 ka parashtruar kërkesë me nr. protokollit 321/07 tek Drejtori e Institutit Pedagogjik të Kosovës, për kompensimin retroaktiv për kryesimin e saj në Këshilli Drejtues (KD), sipas pozitës së ushtrimit në detyrë të Drejtorit të Institutit Pedagogjik të Kosovës(IPK) gjatë periudhës 01.09.2016 deri me datë 12.11.2018, i cili me datë 09.12.2019, i është përgjigjur ankueses duke i refuzuar si të jashtë afatëshme, kërkesën e datës 25.11.2019.

Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen e datës 09.12.2019, ka parashtruar kërkesë me datë 24.12.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Ankuesja, kundër heshtjes së Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me datë 29.01.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me numër protokoll 215/20 përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit përmes postes së Kosovës me numër R 8860868.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 30.01.2020, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit, tek Instituti Pedagogjik të Kosovës dhe Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Me datë 06.02.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë në formë elektronike nga Instituti Pedagogjik të Kosovës/Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me shkresat e bashkëngjitura.

Me datë 06.03.2020 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e ka njoftuar ankuesin lidhur me mos funksionimin e Këshillit sepse nga data 13.12.2018 katër (4) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës u ka skaduar mandati, ndërsa një (1) anëtar nga data 21.01.2019 është emëruar gjyqtar. Aktualisht Këshilli ka ngelur vetëm me dy anëtar. Në këtë kuptim kjo e bënë të pamundur që Këshilli të vendos për ankesën tuaj sepse në bazë të nenit 16 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesat i shqyrton Kolegji prej tre (3) anëtarëve, duke e udhëzuar ankuesin që të vazhdoj me procedurat e mëtejme me mjetin juridike, në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ, për fillimin e procedurës gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesit pasi e kanë pranuar njoftimin e datës 06.03.2020 ka ushtruar kërkesë padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, i cili me datë 21.03.2022 ka nxjerrë Aktgjykimet me numër A.nr.748/20, të cilin me datë 28.03.2022 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ka pranuar dhe ka marrë numër protokoll 1648/2022, të regjistruara me numër A.nr.299/2022, me të cilin është obliguar që të nxjerrë vendim lidhur me ankesën e ankuesit të datës 29.01.2020.

Administrimi i provave: Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Aktgjykimet me numër A.nr.748/20 i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; e Njoftimi i datës 06.03.2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Ankesën me numër Anr.17/2020 të datës 29.01.2020 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 23.01.2020 i Avokatit Dardan Demolli; Vendimi nr.ref.260/01B I datës 29.06.2015; Vendimi Nr.Ref.178/01B i datës 18.08.2016; Vendimi Nr.2-38 i datës 10.01.2019; Vendim nr.497/01B i datës 12.11.2018; Kërkesë nr.321 e datës 25.11.2019; Përgjigje e datës 09.12.2019; Kërkesë e datës 24.12.2019 për komisionin retroaktiv; pliko nga Posta e Kosovës me numër R 8860868; Përgjigje në ankesë nga Instituti i Pedagogjisë së Kosovës me E-mailin e datës 06.02.2020, bashkangjitur përgjigjen nr.26/02 të datës 05.02.2020; Vendim nr.ref.278/2017 i datës 14.12.2017; Vendim nr.2-4381 i datës 13.09.2016; Vendim nr.ref.111/01B i datës 01.06.2017; Vendim nr.ref.059/01B i datës 10.03.2017.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, *sepse është e parashtruar pa i shterur mjetet e brendshme të ankimit.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të dëshmive të ofruara nga ankuesja dhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesja përveç kërkesës së datës 25.11.2019 të cilën e ka parashtruar tek Drejtori i Institutit Pedagogjik të Kosovës, dhe i cili përmes përgjigjes së datës 09.12.2019, ka njoftuar që në momentin kur që keni qenë në dijeni për të drejtat dhe detyrimet që



lidhen me marrëdhënien e punës është dashur që të parashtrijë ankesë në pajtim me nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Bazuar në këtë, por edhe duke i'u referuar provave të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se nuk ka dëshmi që ankuesja lidhur me pretendimet për kompensim retroaktiv të kryesimit të Këshillit Drejtues gjatë periudhës 01.09.2016 deri më datë 12.11.2018, të ketë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Andaj sipas Kolegjit, ankuesja ankesën e datës 29.01.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 50 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili ka përcaktuar se: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të’ rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës. 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë për mbrojtje përmes procedurave të brendshme administrative.....”*, dispozitat e nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit nr.06/L-048 mbi Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku thuhet se: *“para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi apo kandidati, i cili është dëmtuar duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit.....”*, dhe nenit 3 paragrafin 6 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Para parashtrimin të ankesës në Këshill, ankuesi duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit...”*, mbi këtë bazë ankesa e ankueses është e parashtruar para se me i shteruar burimet e brendshme të ankesave.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.299/2022.

Zyle Millaku -GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Avokatit
- Drejtori të Institutit Pedagogjik të Kosovës
- Udhëheqësit të Personalit në Institutit Pedagogjik të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK